

Sektor i veprave civile të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 91 paragrafi 3 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 58/2006...96/2019), të nenit 68 të Rregullores gjyqësore (“Gazeta zyrtare e RM” nr.66/2013), dhe të nenit 41 nga Rregullorja e punës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 13/1998 dhe 21/2009), në seancën e mbajtur më 15.02.2021, miratoi si vijon:

MENDIM JURIDIK

Kur pala në procedurë të zbatimit është person juridik, mbi të cilin është hapur procedurë falimentimi, përmbaruesi duhet të refuzojë propozimin për zbatim, ndërsa procedurat e zbatimit të cilat janë në vijim në kohën e hapjes së procedurës së falimentimit, ndërpriten (neni 146 paragrafi 3).

A r s y e t i m

Avokati PP parashtroi kërkesë me qëllim për unifikimin e praktikës gjyqësore, duke vënë në dukje dy vendime të ndryshme edhe atë nga Gjykata e apelit Shtip dhe nga Gjykata e apelit Shkup.

1. A mundet që pas hapjes së procedurës së falimentimit mbi debitorin, respektivisht me pasojat e bazuara juridike nga hapja e procedurës së falimentimit, kreditorët e veçantë të falimentimit kundër debitorit të kërkojnë zbatimin e pjesëve të pronës që hyn në masën e falimentimit, ose të pronës tjetër të debitorit.

2. Vallë në rast kur pala në procedurën e përmbarimit është person juridik mbi të cilin është hapur procedurë falimentimi, përmbaruesi duhet të refuzojë propozimin për zbatim, i cili është parashtruar pas hapjes së falimentimit ose mund të veprojë për të njëjtin, dhe vallë zbatimet të cilat vijnë në kohën e hapjes së procedurës së falimentimit ndërpriten.

Nga këqyrja në vendimet e bashkëngjitura mund të konstatohet se në të dyja lëndët dokumentet përmbaruese janë realizuar pas hapjes së procedurës së falimentimit si dhe ajo se Gjykata e apelit Shtip merr vendim, me të cilin e refuzon propozimin dhe e lejon përmbarimin, ndërsa Gjykata e apelit Shkup e aprovon propozimin, përcakton se janë bërë cenime gjatë zbatimit dhe urdhrin për zbatimin e shfuqizon.

Në përputhje me nenin 2 paragrafi 1 pika 10 respektivisht pika 64 të Ligjit për falimentim, kreditori i falimentimit është person fizik ose juridik, i cili në çfarëdo baze ka kërkesë ndaj debitorit të falimentimit, e që është paraqitur pas hapjes së procedurës së falimentimit.

Në përputhje me nenin 144 të Ligjit për falimentim, kreditorët e falimentimit mund t' i realizojnë kërkesat e tyre ndaj debitorit vetëm në procedurën e falimentimit.

Në përputhje me nenin 3 nga i njëjti ligj, procedura ka për qëllim përmbushjen kolektive të kreditorëve të debitorit të falimentimit.

Në përputhje me nenin 146 paragrafi 1 të Ligjit për falimentim, pas hapjes së procedurës së falimentimit, kreditorët e veçantë të falimentimit kundër debitorit nuk mund të kërkojnë sigurimin e kërkesave ose zbatimin e pjesëve të pronës që hyn në masën e falimentimit, as të pronës tjetër të debitorit.

Nga e theksuara më parë rrjedh se, me hapjen e procedurës së falimentimit nuk lejohet zbatimi individual i përbarimit. Ndalesa e këtillë, ka për qëllim të pamundësohet ndonjë kreditor i falimentimit të përfitojë të drejtën për përmbushjen e kërkesës së tij në lidhje me kreditorët tjerë, nga prona e debitorit. Në fakt edhe qëllimi i procedurës së falimentimit është të mundësohet përmbushja kolektive e të gjithë kreditorëve.

Duke marrë parasysh të sipër ekspozuarën, referuesi është i mendimit se: Kur pala në procedurën e zbatimit është person juridik mbi të cilin është hapur procedurë e falimentimit, përbaruesi duhet të refuzojë propozimin e zbatimit, ndërsa procedurat e zbatimit që vijnë në kohën e hapjes së procedurës së falimentimit, ndërpriten (neni 146 paragrafi 3).

**Gjykata supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Sektori i veprave civile**